
Kur në ekranin e kamerës afishohet 📍, gjeoetiketimi është ndezur por pozicioni gjeografik nuk është gjetur. Kur afishohet 📍, gjeoetiketimi është ndezur dhe vendndodhja gjeografike është e disponueshme, kështu që fotoja mund të gjeoetiketohet. Kur nuk afishohet asnjë nga këto dy simbole, gjeoetiketimi është hequr.

### Për të aktivizuar gjeoetiketimin

- 1 Aktivizojeni kamerën.
- 2 Takoni ✕, pastaj takoni **Gjeoetiketimi > Aktiv**.
- 3 Trokitni lehtë mbi **OK**, për të aktivizuar GPS-në dhe /ose rrjetet pa tel.
- 4 Kontrolloni opsionet që dëshironi të përzgjidhni nën **Shërbimet e vendndodhjes**.
- 5 Pasi të konfirmoni cilësimet, shtypni ↩ për t'u kthyer tek ekranin e kamerës.
- 6 Nëse 📍 shfaqet në ekranin e kamerës, vendndodhja juaj është e disponueshme dhe fotoja mund të gjeoetiketohet. Nëse jo, kontrolloni lidhjen tuaj GPS dhe/ose lidhjen me rrjetin me valë.

## Përdorimi i cilësimeve të fotokamerës

### Për të rregulluar cilësimet e fotokamerës

- 1 Aktivizojeni kamerën.
- 2 Për të shfaqur të gjitha cilësimet, takoni ✕.
- 3 Përzgjidhni cilësimin që doni të rregulloni dhe pastaj modifikojeni sipas dëshirës.

### Për të përshtatur panelin e cilësimeve të fotokamerës

- 1 Kur kamera është e hapur, takoni ✕, për të shfaqur të gjitha cilësimet.
- 2 Prekni dhe mbani cilësimin që dëshironi të lëvizni dhe tërhiqeni atë tek pozicioni i dëshiruar.

💡 Nëse tërhiqni cilësimin jashtë panelit të cilësimeve, ndryshimi anulohet.


## Pamja e përgjithshme e cilësimeve të fotokamerës

📷 **Normale**

📷 **Kamera e përparme**  
Përzgjidhni kamerën e përparme, nëse dëshironi të nxirni foto autoportreti.





🌀 **Efekt i figurës**  
Përdorni efektet tek fotografitë.

SCN **Përzgjedhja e skenës**  
Përdorni një lloj të skenës së programuar paraprakisht për të cilësuar kamerën për gjendjet e zakonshme.

-  **Lëvizja panoramike**  
Përdorni këtë cilësim për të nxjerrë foto panoramike me kënd të gjerë. Thjesht shtypni tastin e kamerës dhe lëvizeni kamerën në mënyrë të qëndrueshme nga njëra anë në tjetrën.





## Rezolucioni

Zgjidhni ndërmjet disa madhësive dhe raporteve të pamjes përpara nxjerrjes së një fotoje. Një foto me një rezolucion më të lartë kërkon më shumë kujtesë.

-  **2592×1944(4:3)**  
Foto e rezolucionit 5 megapiksel me raportin e pamjes 4:3. E përshtatshme për fotot që dëshironi t'i shihni në ekrane jo të gjera ose t'i stamponi me rezolucion të lartë.
-  **2560×1440(16:9)**  
Foto e rezolucionit 3 megapiksel me raportin e pamjes 16:9.
-  **1632×1224(4:3)**  
Foto e rezolucionit 2 megapiksel me raportin e pamjes 4:3. E përshtatshme për fotot që dëshironi t'i shihni në ekrane jo të gjera.
-  **1920×1080(16:9)**  
Foto e rezolucionit 2 megapiksel me raportin e pamjes 16:9. E përshtatshme për fotot që dëshironi t'i shihni në ekrane të gjera.




## Blici

Përdorni blicin për të nxjerrë foto kur ndriçimi është i pamjaftueshëm ose kur ka një ndriçim të kundërt.

-  **Automatik**  
Kamera përcakton automatikisht nëse kushtet e ndriçimit kërkojnë përdorimin e një blici.
-  **Mbush flashin**  
Përdorni këtë cilësim kur sfondi është më i shkëlqyeshëm sesa subjekti. Kjo heq hijet e errëta të padëshirueshme.
-  **Joaktiv**  
Blici hiqet. Ndonjëherë cilësia e fotos është më e mirë pa blic, edhe sikur ndriçimi të jetë i pamjaftueshëm. Për të nxjerrë një foto të mirë pa blic duhet ta mbani dorën të palëvizur. Përdorni kohëvonuesin për të shmangur fotot e turbullta.
-  **Reduktimi i syrit të kuq**  
Zvogëlon ngjyrën e kuqe të syve kur nxirrni një foto.

## Kohëvonues

Me kohëvonuesin mund të nxirrni një foto pa e mbajtur në dorë pajisjen. Përdorni këtë funksion për të bërë autoportrete ose foto në grup, ku të gjithë mund të jenë në foto. Kohëvonuesin mund ta përdorni edhe për të shmangur lëvizjen e kamerës kur po nxirrni foto.






-  **Aktiv (10 s.)**  
Cilësoni një vonesë prej 10 sekondash që nga trokitja e lehtë e ekranit të kamerës deri në nxjerrjen e fotos.
-  **Aktiv (2 s.)**  
Cilësoni një vonesë prej 2 sekondash që nga trokitja e lehtë e ekranit të kamerës deri në nxjerrjen e fotos.
-  **Joaktiv**  
Fotoja nxirret sapo të trokitni lehtë mbi ekranin e kamerës.

## Smile Shutter™

Përdorni funksionin Smile Shutter™ për të përcaktuar se ndaj cilit lloj buzëqeshjeje të reagojë kamera përpara nxjerrjes së një fotoje.




## Hapja e shpejtë

Përdorni cilësimet e hapjes së shpejtë për të hapur kameran nga ekrani i kyçjes. Nëse pajisja është në modalitetin e fjetjes, shtypni tastin e kamerës.

-  **Hape dhe fotografo**  
Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, fotoja e parë nxirret menjëherë pasi kamera niset nga mënyra e gjumit.
-  **Vetëm hape (fotokamerë)**  
Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, kamera niset nga mënyra e gjumit.
-  **Hape dhe regjistro videon**  
Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, video e parë nxirret menjëherë pasi videokamera niset nga mënyra e gjumit.
-  **Vetëm hape (videokamera)**  
Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, videokamera niset nga mënyra e gjumit.
-  **Joaktiv**


## Mënyra e fokusimit

Funksioni i fokusit kontrollon se cila pjesë e një fotoje duhet të duket qartë. Kur vetëfokusimi i vazhdueshëm është aktiv, kamera vazhdon të rregullojë fokusin, në mënyrë që zona brenda kornizës së verdhë të fokusit të qëndrojë e qartë.

-  **Fokusi automatik i një subjekti**  
Kamera fokusohet automatikisht mbi objektin e përzgjedhur. Vetëfokusimi i vazhdueshëm është aktiv. Prekni dhe mbani ekranin e kamerës derisa korniza e verdhë e fokusit bëhet blu, duke treguar se fokusi është vendosur. Fotoja nxirret kur ju hiqni gishtin.
-  **Dallimi i fytyrave**  
Kamera dallon automatikisht deri në pesë fytyra njerëzish, të treguara nga kornizat në ekran. Kamera fokusohet automatikisht mbi fytyrën më të afërt. Gjithashtu mund të përzgjidhni se në cilën fytyrë të fokusoheni duke trokitur lehtë mbi të në ekran. Kur trokitni lehtë mbi ekranin e kamerës, një kornizë blu tregon se cila fytyrë është e përzgjedhur dhe në fokus. Dallimi i fytyrës nuk mund të përdoret për të gjitha llojet e skenave. Vetëfokusimi i vazhdueshëm është aktiv.
-  **Fokusi me prekje**  
Prekni një zonë të veçantë në ekranin e kamerës për të cilësuar zonën e fokusit. Vetëfokusimi i vazhdueshëm është joaktiv. Prekni dhe mbani ekranin e kamerës derisa korniza e verdhë e fokusit bëhet blu, duke treguar se fokusi është vendosur. Fotoja nxirret kur ju hiqni gishtin.

! Ky cilësim disponohet vetëm në mënyrën e nxjerrjes **Normale**.

## Vlera e ekspozimit

-  Përcakton sasinë e dritës në foton që dëshironi të nxirni. Një vlerë më e lartë tregon një sasi në rritje të dritës.

! Ky cilësim disponohet vetëm në mënyrën e nxjerrjes **Normale**.




## HDR

Përdorni cilësimin e HDR (Sfera e Lartë Dinamike) për të bërë një foto ndaj një drite të fortë nga pas ose në kushte kur kontrasti është i mprehtë. HDR kompenson për humbjen e hollësisë dhe prodhon një fotografi që përfaqëson zonat e errta dhe të shndritshme.


! Ky cilësim disponohet vetëm në mënyrën e nxjerrjes **Normale**.

## Balanca e të bardhës

Cilësimi i balancës së të bardhës rregullon balancën e ngjyrave sipas kushteve të ndriçimit.

-  **Automatike**  
Rregullon automatikisht balancën e ngjyrave sipas kushteve të ndriçimit.
-  **Inkandeshente**  
Rregullon balancën e ngjyrave për kushtet e një ndriçimi të butë si p.sh. nën llampat e dritës.
-  **Fluoreshente**  
Rregullon balancën e ngjyrave për ndriçimin fluoreshent.

 **Dritë dite**  
Rregullon balancën e ngjyrave për kushtet e mjediseve të jashtme me diell.

 **Me re**  
Rregullon balancën e ngjyrave për një qiell me re.

! Ky cilësim disponohet vetëm në mënyrën e nxjerrjes **Normale**.

## ISO

Mund ta zvogëloni turbullimin e imazhit të shkaktuar nga errësira ose nga subjektet që lëvizin, duke rritur ndjeshmërinë ISO.

 **Automatik**  
Cilëson automatikisht ndjeshmërinë ISO.

 **100**  
Cilëson ndjeshmërinë ISO në 100.

 **200**  
Cilëson ndjeshmërinë ISO në 200.

 **400**  
Cilëson ndjeshmërinë ISO në 400.

 **800**  
Cilëson ndjeshmërinë ISO në 800.

! Ky cilësim disponohet vetëm në mënyrën e nxjerrjes **Normale**.

## Matja

Ky funksion përcakton automatikisht një ekspozim të ekuilibruar mirë, duke matur sasinë e dritës që bie në imazhin që dëshironi të fotografoni.

 **Në qendër**  
Rregullon ekspozimin në qendër të imazhit.

 **Mesatare**  
Logarit ekspozimin sipas sasisë së dritës që bie në të gjithë imazhin.

 **Selektive**  
Rregullon ekspozimin në një pjesë shumë të vogël të imazhit që dëshironi të fotografoni.




! Ky cilësim disponohet vetëm në mënyrën e nxjerrjes **Normale**.


## Stabilizuesi i imazhit

Kur nxirri një foto, mund të jetë e vështirë që ta mbani pajisjen pa lëvizur. Stabilizuesi ju ndihmon duke kompensuar lëvizjet e vogla të dorës.

## Gjeoetiketimi

Etiketoni fotot me hollësitë se ku i nxorrët ato.

 **Aktiv**  
Kur aktivizohet gjeoetiketimi, te fotot shtohet vendndodhja e përafërt gjeografike kur i nxirri. Për të përdorur gjeoetiketimin, duhet të aktivizoni tiparet e vendndodhjes nga menya **Cilësimet**. Që në një foto të shtohen gjeoetiketat, para se të nxirri foton duhet të përcaktohet vendndodhja. Vendndodhja juaj përcaktohet kur shfaqet  në ekranin e kamerës. Kur pajisja juaj është duke kërkuar pozicionin tuaj, shfaqet .

 **Joaktiv**  
Kur gjeoetiketimi është hequr, nuk mund të shihni vendndodhjen ku nxorrët një foto.

## Shikimi paraprak

Mund të zgjidhni të shihni paraprakisht fotot ose videot menjëherë pasi i nxirri ato.



#### **I pakufizuar**

Shikimi paraprak i fotos ose videos shfaqet pasi e keni nxjerrë atë.



#### **5 sekonda**

Shikimi paraprak i fotos ose videos shfaqet për 5 sekonda pasi e keni nxjerrë atë.



#### **3 sekonda**

Shikimi paraprak i fotos ose videos shfaqet për 3 sekonda pasi e keni nxjerrë atë.



#### **Modifiko**

Fotoja ose videoja hapet për modifikim pasi e keni nxjerrë atë.



#### **Joaktiv**

Fotoja ose videoja ruhet pasi e keni nxjerrë atë dhe nuk shfaqet asnjë shikim paraprak.

! Ky cilësim disponohet vetëm në mënyrën e nxjerrjes **Normale**.

## Ngarkimi automatik

Ngarkoni automatikisht përditësime të fotograive në një shërbim të paracaktuar të rrjetit social (SNS).

## Marrje me prekje

Identifikoni një zonë të caktuar të fokusit, duke prekur me gisht ekranin e kamerës. Fotoja nxirret sapo të hiqni gishtin. Ky cilësim është i disponueshëm vetëm kur mënyra e fokusimit është cilësuar në prekjen e fokusit.



**Aktiv**



**Joaktiv**

## Tingulli shkrepës

Zgjidhni të ndizni ose të fiknin tingullin shkrepës kur rregjistroni një video.

## Ruajtja e të dhënave

Mund të zgjidhni të ruani të dhënat tuaja ose në një kartë SD të heqshme ose në hapësirën ruajtëse të brendshme.



#### **Hapësira ruajtëse e brendshme**

Fotot ose videot ruhen në kujtesën e pajisjes.



#### **Karta SD**

Fotot ose videot ruhen në kartën SD.

## Përdorimi i videokamerës



### Për të rregjistruar një video duke përdorur tastin e kamerës

- 1 Aktivizojeni kamerën.
- 2 Për të filluar rregjistrimin e një videoje, shtypni tastin e kamerës.
- 3 Për të ndaluar rregjistrimin, shtypni tastin e kamerës përsëri.



Rregjistroni videot tuaja në orientimin peisazhi për të marë rezultatet më të mira.





### Për të rregjistruar një video duke takuar ekranin

- 1 Aktivizojeni kamerën.
- 2 Drejtoni kamerën ndaj subjektit.
- 3 Takoni  për të nisur rregjistrimin.
- 4 Takoni  për të ndaluar rregjistrimin.



Rregjistroni videot tuaja në orientimin peisazhi për të marë rezultatet më të mira.

## Për të riprodhuar videot e regjistruara


- 1 Aktivizojeni kamerën.
- 2 Takoni miniaturat në pjesën e sipërme djathtas të ekranit.
- 3 Goditni lehtë majtas ose djathtas për të shfletuar të gjithë skedarët e fotove dhe të videove. Videot identifikohen nga .
- 4 Takoni , për të riprodhuar një video.
- 5 Për të ndaluar riprodhimin e videos, takoni  ose .

## Për të fshirë një video të regjistruar


- 1 Shfletoni për te videoja që dëshironi të fshini.
- 2 Trokitni lehtë në ekran për të shfaqur .
- 3 Trokitni lehtë mbi .
- 4 Trokitni lehtë mbi **Fshij** për të konfirmuar.

## Përdorimi i cilësimeve të videokamerës

### Për të rregulluar cilësimet e videokamerës

- 1 Aktivizojeni kamerën.
- 2 Takoni një nga ikonat e cilësimeve në ekran.
- 3 Për të shfaqur të gjitha cilësimet, takoni .
- 4 Përzgjidhni cilësimin që dëshironi të rregulloni, pastaj bëni ndryshimet tuaja.

### Për të përshtatur panelin e cilësimeve të videokamerës

- 1 Kur videokamera është e ndezur, takoni  për të shfaqur të gjitha cilësimet.
- 2 Prekni dhe mbani cilësimin që dëshironi të zhvendosni, pastaj tërhiqeni tek pozicioni i dëshiruar.

 Nëse tërhiqni cilësimin jashtë panelit të cilësimeve, ndryshimi anulohet.

## Pamja e përgjithshme e cilësimeve të videokamerës



### Videokamera

Përzgjidhni videokamerën kryesore për të regjistruar videot.



### Videoja e përparme

Përzgjidhni videokamerën e përparme për të regjistruar video autoportret.

## Skenat

Tipari Skenat ju ndihmon për ta konfiguruar shpejt kamerën për situata të zakonshme, duke përdorur skenat e paraprogramuara. Kamera përcakton një numër cilësimesh, që të përshtatni skenën e përzgjedhur, duke siguruar videon më të mirë të mundshme.



### Joaktiv

Tipari Skenat është joaktiv dhe mund të regjistrojë video me dorë.



### Marje artistike

Përdorni për rregjistrimin e videove ndaj sfondeve të butë.



### Peizazh

Përdoreni për video peizazhi. Kamera fokusohet në objekte të largëta.



### Natën

Kur është aktive, ndjeshmëria ndaj dritës shtohet. Përdoreni në mjedise me ndriçim të pamjaftueshëm. Videot e objekteve që lëvizin me shpejtësi mund të jenë të turbullta. Mbajeni dorën të palëvizur, ose përdorni një mbështetje. Çaktivizojeni mënyrën për natën kur kushtet e ndriçimit janë të mira, për të përmirësuar cilësinë e videos.



### Plazh dhe borë

Përdoreni në mjedise të ndritshme, për të shmangur video të ekspozuara në mënyrë të pamjaftueshme.



### Sporte

Përdoreni për video objektësh që lëvizin me shpejtësi. Koha e shkurtër e ekspozimit e minimizon turbullimin prej lëvizjes.



### Festë



Përdoreni për video në mjedise të brendshme me ndriçim të pamjaftueshëm. Kjo skenë zgjedh ndriçimin e sfondit në mjedise të brendshme ose dritën e qirinjve. Videot e objekteve që lëvizin me shpejtësi mund të jenë të turbullta. Mbajeni dorën të palëvizur, ose përdorni një mbështetje.

## Rezolucioni i videos

Rregulloni rezolucionin e videos për formatet e ndryshme.



### **1280×720(16:9)**

Formati HD (me definicion të lartë) me raportin e pamjes 16:9. 1280×720 piksel.



### **640×480(4:3)**

Formati VGA me raportin e pamjes 4:3. 640×480 piksel.



### **320×240(4:3)**

Formati një e katërta VGA me raportin e pamjes 4:3. 320×240 piksel.



### **176×144(11:9)**

Regjistroni video të përshtatshme për t'u dërguar me mesazhe multimediale. Koha e regjistrimit të këtij formati të videos është e kufizuar, për t'u futur në një mesazh multimedial.

## Dritë për foto

Përdorni dritën për të regjistruar video kur ndriçimi është i pamjaftueshëm ose kur ka dritë të kundërt.

**Aktiv**

**Joaktiv**

Ndonjë herë cilësia e videos mund të jetë më e mirë pa dritë, edhe nëse ndriçimi është i pamjaftueshëm.

## Kohëvonues

Duke përdorur kohëvonuesin, mund të regjistroni një video pa e mbajtur në dorë pajisjen. Përdoreni për të regjistruar video grupi, ku të gjithë mund të jenë në video. Kohëvonuesin mund ta përdorni edhe për të shmangur tronditjen e kamerës gjatë regjistrimit të videove.

**Aktiv (10 s.)**

Cilësoni një vonesë prej 10 sekondash, që nga trokitja e lehtë e ekranit të kamerës deri sa të fillojë regjistrimi i videos.

**Aktiv (2 s.)**

Cilësoni një vonesë prej 2 sekondash, që nga trokitja e lehtë e ekranit të kamerës deri sa të fillojë regjistrimi i videos.

**Joaktiv**

Videoja fillon të regjistrohet sapo të trokitni lehtë mbi ekranin e kamerës.

## Hapja e shpejtë

Përdorni cilësimet e hapjes së shpejtë për të hapur kameran nga ekrani i kyçjes. Nëse pajisja është në modalitetin e fjetjes, shtypni tastin e kamerës.



### **Hape dhe fotografo**

Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, fotoja e parë nxirret menjëherë pasi kamera niset nga mënyra e gjumit.



### **Vetëm hape (fotokamerë)**

Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, kamera niset nga mënyra e gjumit.



### **Hape dhe regjistro videon**

Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, video e parë nxirret menjëherë pasi videokamera niset nga mënyra e gjumit.



### **Vetëm hape (videokamera)**

Duke shtypur pak çaste tastin e kamerës, videokamera niset nga mënyra e gjumit.



### **Joaktiv**

## Mënyra e fokusimit

Cilësimi i fokusit kontrollon se cila pjesë e një videoje duhet të duket qartë. Kur vetëfokusimi i vazhdueshëm është aktiv, kamera vazhdon të rregullojë fokusin, në mënyrë që zona brenda kornizës së bardhë të fokusit të qëndrojë e qartë.



### Fokusi automatik i një subjekti

Kamera fokusohet automatikisht mbi objektin e përzgjedhur. Vetëfokusimi i vazhdueshëm është aktiv.



### Dallimi i fytyrave

Kamera dallon automatikisht deri në pesë fytyra njerëzish, të treguara nga kornizat në ekran. Kamera fokusohet automatikisht mbi fytyrën më të afërt. Gjithashtu mund të përzgjidhni se në cilën fytyrë të fokusoheni duke trokitur lehtë mbi të në ekran. Kur takoni ekranin e kamerës, një kornizë e gjelbër tregon se cila fytyrë është e përzgjedhur dhe në fokus. Dallimi i fytyrës nuk mund të përdoret për të gjitha llojet e skenave. Vetëfokusimi i vazhdueshëm është aktiv.

## Vlera e ekspozimit



Ky cilësim ju lejon të përcaktoni sasinë e dritës në imazhin që merrni në video. Një vlerë më e lartë tregon një sasi në rritje të dritës.

## Balanca e të bardhës

Cilësimi i balancës së të bardhës rregullon balancën e ngjyrave sipas kushteve të ndriçimit.



### Automatike

Rregulloni automatikisht balancën e ngjyrave sipas kushteve të ndriçimit.



### Inkandeshente

Rregullon balancën e ngjyrave për kushtet e një ndriçimi të butë si p.sh. nën llambat e dritës.



### Fluoreshente

Rregulloni balancën e ngjyrave për ndriçimin fluoreshent.



### Dritë dite

Rregulloni balancën e ngjyrave për kushtet e mjediseve të jashtme me diell.



### Me re

Rregulloni balancën e ngjyrave për një qiell me re.

## Matja

Ky funksion përcakton automatikisht një ekspozim të ekuilibruar mirë, duke matur sasinë e dritës që bie në imazhin që dëshironi të fotografoni.



### Në qendër

Rregulloni ekspozimin në qendër të imazhit.



### Mesatare

Logarisni ekspozimin sipas sasisë së dritës që bie në të gjithë imazhin.



### Selektive

Rregulloni ekspozimin në një pjesë shumë të vogël të imazhit që dëshironi të fotografoni.

## Stabilizuesi i imazhit

Gjatë regjistrimit të një videoje, mund ta keni të vështirë ta mbani pajisjen pa lëvizur. Stabilizuesi ju ndihmon duke kompensuar lëvizjet e vogla të dorës.



## Gjeoetiketimi

Etiketoni videot me hollësitë se ku i nxorrët ato.



### Aktiv

Kur aktivizohet gjeoetiketimi, te videot shtohet vendndodhja e përafërt gjeografike kur i nxirrni. Për të përdorur gjeoetiketimin, duhet të aktivizoni tiparet e vendndodhjes nga menyuja **Cilësimet**. Që në një video t'i shtohen gjeoetiketat, para se të nxirrni videon duhet të përcaktohet vendndodhja. Vendndodhja

juaj përcaktohet kur shfaqet  në ekranin e kamerës. Kur pajisja juaj është duke kërkuar pozicionin tuaj, shfaqet .



### **Joaktiv**

Kur gjeoetiketimi është hequr, nuk mund të shihni vendndodhjen ku nxorrët një video.

## Mikrofoni

Përzgjidhni nëse do të regjistroni tingullin përreth gjatë regjistrimit të videos.

## Marrje me prekje

Identifikoni një zonë të caktuar të fokusit, duke prekur me gisht ekranin e kamerës. Fotoja nxirret sapo të hiqni gishtin. Ky cilësim është i disponueshëm vetëm kur mënyra e fokusimit është cilësuar në prekjen e fokusit.



**Aktiv**



**Joaktiv**

## Tingulli shkrepës

Zgjidhni të ndizni ose të fiknin tingullin shkrepës kur regjistroni një video.

## Ruajtja e të dhënave

Mund të zgjidhni të ruani të dhënat tuaja ose në një kartë SD të heqshme ose në hapësirën ruajtëse të brendshme.



### **Hapësira ruajtëse e brendshme**

Fotot ose videot ruhen në kujtesën e pajisjes.



### **Karta SD**

Fotot ose videot ruhen në kartën SD.

# Album

## Rreth albumit

Përdoreni Albumin për të parë fotot dhe për të riprodhuar videot që keni nxjerrë me kamerën tuaj ose për të parë përmbajtje të ngjashme që keni shkarkuar në pajisjen tuaj. Mund të merrni gjeotiketime për fotot dhe videot tuaja dhe pastaj t'i shihni ato në një hartë të botës. Te Albumi mund të shihni edhe fotot dhe videot që keni ngarkuar në një shërbim në internet, për shembull në një album në internet të Picasa™ ose në Facebook™.

Nga Albumi mund të ndani fotot dhe videot tuaja të preferuara me miqtë nëpërmjet teknologjisë me valë Bluetooth™, postës elektronike, mesazhimit dhe shërbimeve të ndryshme në internet. Gjithashtu mund të kryheni detyra të modifikimit themelor të fotot dhe t'i cilësoni si sfond ose si figura kontakti.

## Pamja e përgjithshme e skedave të Albumit

Skedat e mëposhtme janë të disponueshme në Album:

- **Figurat** – shihni të gjitha fotot dhe videot e ruajtura në pajisjen tuaj.
- **Albumet e mia** – shihni albumet tuaja në linjë si edhe fotot dhe videoklipet tuaja të gjeotiketuara në një hartë të botës.

### Për të hapur albumin

- 1 Nga Ekranin fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeneroni dhe takoni **Albumi**.
- 💡 Nëse orientimi i ekranit nuk ndryshon automatikisht kur e ktheni pajisjen tuaj anash, shënoni kutinë e shënimit **Vetërrotullo ekranin** nën **Cilësimet** > **Ekranin**.

## Shikimi i fotove dhe videove në kartelën Figurat

Në kartelën **Figurat** në album mund të shihni fotot dhe videot tuaja në miniaturë në një pamje tabele.




## Pamja e përgjithshme e kartelës Figurat



- 1 Shikimi i tabelës së fotove dhe videove.
- 2 Shihni opsionet e menysë.
- 3 Lundroni lart ose poshtë për të parë përmbajtje.

- 4 Takoni një foto ose video për t'a parë.
- 5 Data dhe numri i objekteve në grupin më poshtë.



### Për të parë fotot dhe videot në shikimin e tabelës

- 1 Nga Ekranin fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeni dhe takoni **Albumi**. Të gjitha fotot dhe videot shfaqen në një tabelë sipas rendit kronologjik. Videot tregohen nga .
  - 3 Takoni një foto ose video për t'a parë.
  - 4 Goditni lehtë majtas për të parë foton ose videon pasardhëse. Goditni lehtë djathtas për të parë foton ose videon e mëparshme.
-  Nëse orientimi i ekranit nuk ndryshon automatikisht kur e ktheni pajisjen tuaj anash, shënoni kutinë e shënimit **Vetërrotullo ekranin** nën **Cilësimet > Ekranin**.

### Për të ndryshuar madhësinë e miniaturave në album

- Kur shihni miniaturat e ftove dhe videove në album, ndani dy gishta për t'a zmadhuar ose bashkojini gishtat për t'a zvogëluar.

### Për të punuar me grupe fotosh ose videosh në album

- 1 Kur shihni miniaturat e ftove dhe videove në album, takoni , pastaj takoni **Objektet e përzgjedhura**.
  - 2 Takoni objektet me të cilat dëshironi të punoni. Objektet e përzgjedhur tregohen me një kornizë blu.
  - 3 Përdorni veglat në shiritin e veglave në pjesën e sipërme të ekranit për të punuar me objektet tuaj të zgjedhur.
-  Për të aktivizuar modalitetin e përzgjedhjes, gjithashtu mund të prekni dhe të mbani një objekt derisa korniza e tij të shndërrohet në blu. Pastaj mund të takoni objekte të tjerë për t'i zgjedhur ata.

## Shikimi i ftove dhe videove në kartelën Albumet e mia

Pllakëzat në vijim janë të disponueshme tek Albumet e mia:

- **Albumet e kamerës** – shihni të gjitha fotot dhe videot e bëra me kamerën e pajisjes tuaj.
- **Kujtesa e brendshme** – shihni të gjitha fotot dhe videot e ruajtura në hapësirën ruajtëse të brendshme të pajisjes tuaj.
- **Karta ime SD** – shihni të gjitha fotot dhe videot e ruajtura në një kartë kujtese të lëvizshme në pajisjen tuaj.




## Pamja e përgjithshme e kartelës Albumet e mia






- 1 Shihni fotot dhe videot në Facebook™.
- 2 Shihni fotot dhe videot në Picasa™.

- 3 Shihni të gjitha foto dhe videot e nxjerra me kamerën e pajisjes tuaj.
- 4 Shini fotot tuaja në modalitetin global.
- 5 Shini fotot tuaja në një hartë.
- 6 Shihni të gjitha fotot dhe videot e ruajtura në hapësirën ruajtëse të brendshme të telefonit.
- 7 Shihni të gjitha fotot dhe videot e ruajtura në kartën e heqshme të kujtesës.




### Për të parë përmbajtjen në shikimin e listës në pllakën e albumeve të kameras

- 1 Nga Ekran i fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeni dhe takoni **Albumi > Albumet e mia > Albumet e kamerës**.
  - 3 Takoni një dosje që dëshironi të hapni. Përmbajtja e dosjes shfaqet në tabelën sipas renditjes kronologjike. Videot tregohen nga .
  - 4 Takoni një foto ose video për t'a parë.
  - 5 Goditni lehtë majtas për të parë foton ose videon pasardhëse. Goditni lehtë djathtas për të parë foton ose videon e mëparshme.
-  Nëse orientimi i ekranit nuk ndryshon automatikisht kur e ktheni pajisjen tuaj anash, shënoni kutinë e shënimit **Vetërrotullo ekranin** nën **Cilësimet > Ekran**.



### Për të parë përmbajtjen në shikimin e listës në pllakën e kujtesës së brendshme

- 1 Nga Ekran i fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeni dhe takoni **Albumi > Albumet e mia > Kujtesa e brendshme**.
  - 3 Takoni një dosje që dëshironi të hapni. Përmbajtja e dosjes shfaqet në tabelën sipas renditjes kronologjike. Videot tregohen nga .
  - 4 Takoni një foto ose video për t'a parë.
  - 5 Goditni lehtë majtas për të parë foton ose videon pasardhëse. Goditni lehtë djathtas për të parë foton ose videon e mëparshme.
-  Nëse orientimi i ekranit nuk ndryshon automatikisht kur e ktheni pajisjen tuaj anash, shënoni kutinë e shënimit **Vetërrotullo ekranin** nën **Cilësimet > Ekran**.

### Për të parë përmbajtjen në shikimin e listës në pllakën e kartës time SD

- 1 Nga Ekran i fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeni dhe takoni **Albumi > Albumet e mia > Karta ime SD**.
  - 3 Takoni një dosje që dëshironi të hapni. Përmbajtja e dosjes shfaqet në tabelën sipas renditjes kronologjike. Videot tregohen nga .
  - 4 Takoni një foto ose video për t'a parë.
  - 5 Goditni lehtë majtas për të parë foton ose videon pasardhëse. Goditni lehtë djathtas për të parë foton ose videon e mëparshme.
-  Nëse orientimi i ekranit nuk ndryshon automatikisht kur e ktheni pajisjen tuaj anash, shënoni kutinë e shënimit **Vetërrotullo ekranin** nën **Cilësimet > Ekran**.

### Për të parë fotot me fytyra në shikimin e listës në pllakën Fytyra

- 1 Nga Ekran i fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeni dhe takoni **Albumi > Albumet e mia > Fytyrat**.
  - 3 Takoni një dosje që dëshironi të hapni. Përmbajtja e dosjes shfaqet në tabelën sipas renditjes kronologjike.
  - 4 Trokitni lehtë mbi një foto për ta parë.
  - 5 Goditni lehtë majtas për të parë foton pasardhëse. Goditni lehtë djathtas për të parë videon e mëparshme.
-  Nëse orientimi i ekranit nuk ndryshon automatikisht kur e ktheni pajisjen tuaj anash, shënoni kutinë e shënimit **Vetërrotullo ekranin** nën **Cilësimet > Ekran**.


## Të punuarit me fotot në album

Mund të modifikoni fotot në album. Për shembull, mund të prisni fotot, ti shoqëroni me kontakte ose t'i përdorni si sfond.




### Për të zmadhuar një foto

- Kur jeni duke parë një foto, takoni dy herë ekranin për t'a zmadhuar. Takoni dy herë përsëri për t'a zvogëluar.
- Kur jeni duke parë një foto, ndani gishtat për t'a zmadhuar ose bashkojini gishtat për t'a zmadhuar.

### Për të parë një panoramë të fotove tuaja

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni , pastaj takoni **Paraqitja e diapozitivave** për të filluar riprodhimin e të gjitha fotove në një album.
- 2 Takoni një foto për t'i dhënë fund panoramës.



### Për të parë një panoramë të fotove tuaja me muzikë

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni  > **SensMe™ slideshow**.
- 2 Përzgjidhni muzikën dhe temën që dëshironi të përdorni për panoramën, pastaj takoni . Aplikacioni i albumit analizon fotot tuaja dhe përdor të dhënat muzikore të SensMe™ për të riprodhuar një panoramë.
- 3 Për të ndërprerë riprodhimin, takoni ekranin për të shfaqur komandat, pastaj takoni .


### Për të rrotulluar një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni .
- 2 Përzgjidhni **Rrotulloje majtas** ose **Rrotulloje djathtas**. Fotoja ruhet me orientimin e ri.

### Për të prerë një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni  > **Modifiko foton** >  > **Prit**.
- 2 Për të rregulluar kornizën e prerjes, prekni dhe mbani anën e kornizës së prerjes. Kur katrorët në cepa zhduken, tërhiqni nga brenda ose nga jashtë për të ndryshuar madhësinë e kornizës.
- 3 Për të ndryshuar njëkohësisht të gjitha anët e kornizës së prerjes, prekni dhe mbani të prekur njërin prej katër cepave për të zhdukur katrorët tek cepat, pastaj tërhiqeni cepin si duhet.
- 4 Për t'a lëvizur kornizën e prerjes në një zonë tjetër të fotos, prekni brenda dhe mbajeni kornizën, pastaj tërhiqeni për në pozicionin e dëshiruar.
- 5 Për të ruajtur një kopje të fotos së prerë, takoni **Ruaj**. Versioni origjinal i paprerë mbetet në pajisjen tuaj.


### Për të përdorur një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni  > **Përdor si**.
- 2 Përzgjidhni një opsion nga lista që shfaqet.
- 3 Ndiqni hapat përkatës për të përdorur foton.


### Për të ndryshuar një foto

- Kur jeni duke parë një foto, takoni , pastaj takoni **Modifiko foton**.


### Për të përdorur efektet speciale për një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni **Modifiko foton** > .
  - 2 Përzgjidhni një opsion.
  - 3 Për të ruajtur një kopje të fotos së modifikuar, takoni **Ruaj**.
- ! Pasi keni ruajtur foton e modifikuar, versioni origjinal i pandryshuar i fotos mbetet në pajisjen tuaj.



### Për të përmirësuar një foto duke përdorur cilësimet e përparuara

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni **Modifiko foton** > .
  - 2 Përzgjidhni një opsion.
  - 3 Për të ruajtur një kopje të fotos së modifikuar, takoni **Ruaj**.
- ! Pasi keni ruajtur foton e modifikuar, versioni origjinal i pandryshuar i fotos mbetet në pajisjen tuaj.


### Për të rregulluar cilësimet e dritë për një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni **Modifiko foton** > .
  - 2 Përzgjidhni një opsion.
  - 3 Për të ruajtur një kopje të fotos së modifikuar, takoni **Ruaj**.
- ! Pasi keni ruajtur foton e modifikuar, versioni origjinal i pandryshuar i fotos mbetet në pajisjen tuaj.



### Për të cilësuar nivelin e mbushjes së ngjyrave në një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni  > **Modifiko foton** > .
  - 2 Përzgjidhni një opsion.
  - 3 Për të ruajtur një kopje të fotos së modifikuar, takoni **Ruaj**.
- ! Pasi keni ruajtur foton e modifikuar, versioni origjinal i pandryshuar i fotos mbetet në pajisjen tuaj.


### Për të ndarë një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni .
- 2 Në menynë që hapet, takoni aplikacionin që dëshironi të përdorni për të ndarë foton e përzgjedhur, pastaj ndiqni hapat për t'a dërguar atë.

### Për të shkuar një gjeotiketë në një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni  për të hapur ekranin e hartës.
  - 2 Gjeni dhe takoni vendndodhjen e dëshiruar për të vendosur foton në hartë.
  - 3 Për të rregulluar vendndodhjen e fotos, takoni vendndodhjen në hartë ku dëshironi të zhvendosni foton.
  - 4 Kur të keni përfunduar, takoni **OK** për të ruajtur gjeotiketimin dhe kthehuni tek shikuesi i fotos.
- 💡 Kur një foto është gjeotiketuar,  shfaqet së bashku me informacionin e vendndodhjes. Mund të takoni këtë ikonë për të parë foton në një hartë.

### Për të fshirë një foto

- 1 Kur jeni duke parë një foto, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni  > **Fshi**.
- 2 Takoni **Fshi**.

## Analizimi i fotove me fytyra tek Albumi

Mund të analizoni të gjitha fotot në pajisjen tuaj që paraqesin fytyra njerëzish. Pasi të aktivizohet, tipari i analizimit të fotove qëndron aktiv dhe fotot e reja analizohen ndërsa shtohen. Pas ekzekutimit të një analize, mund t'i gruposh në një dosje të gjitha fotot e të njëjtit person.




### Për të aktivizuar tiparin e analizimit të fotove

- 1 Nga Ekрани fillestar, trokitni lehtë mbi .
- 2 Gjeni dhe trokitni lehtë mbi **Albumi > Albumet e mia > Fytyrat**.
- 3 Trokitni lehtë mbi **Aktivizo**. Të gjitha fotot në pajisjen tuaj analizohen dhe grupohen sipas nevojës.

### Për të emërtuar një fytyrë

- 1 Në pllakëzën Fytyrat, shfletoni një dosje me fytyra të paemërtuara dhe zgjidhni fytyrën që dëshironi të emërtoni.
- 2 Trokitni lehtë mbi **Shto emrin**.
- 3 Shtypni një emër dhe më pas trokitni lehtë mbi **OK**.

### Për të modifikuar një emër të fytyrës

- 1 Kur jeni duke parë një fytyrë në shikimin e ekranit të plotë, takoni ekranin për të shfaqur shiritat, pastaj takoni  > **Modifiko etiketat e emrave**.
- 2 Takoni emrin e fytyrës për të modifikuar emrin.
- 3 Shtypni një emër, pastaj takoni **OK**.


## Të punuarit me videot në Album

Përdoreni Albumin për të parë videot që keni nxjerrë me kamerën, që keni shkarkuar ose që keni kopjuar në pajisjen tuaj. Gjithashtu mund të ndani videot tuaja me miqtë, për shembull duke i ngarkuar ato në shërbimet në internet.

### Për të riprodhuar një video

- 1 Hapni kartelën **Figurat** ose kartelën **Albumet e mia** në Album.
- 2 Duke përdorur shikimin në tabelë ose shikimin në listë, gjeni videon që dëshironi të hapni.
- 3 Takoni videon për t'a riprodhuar atë.
- 4 Nëse komandat e riprodhimit nuk shfaqen, takoni ekranin për t'i shfaqur ato. Për të fshirë komandant, takoni ekranin përsëri.

### Për të vënë në pauzë një video

- 1 Kur një video është duke u riprodhuar, trokitni lehtë mbi ekran për të afishuar kontrollet.
- 2 Takoni .


### Për ta përparuar shpejt dhe rimbështjellë një video

- 1 Kur një video është duke u riprodhuar, trokitni lehtë mbi ekran për të afishuar kontrollet.
- 2 Tërhiqeni treguesin e shiritit të përparimit majtas për të rikthyer ose djathtas për të kaluar shpejt.


### Për të rregulluar volumin e një videoje

- Shtypni tastin e volumit.

### Për të ndarë një video

- 1 Kur një video është duke u riprodhuar, takoni , pastaj takoni **Bashkëndaj**.
  - 2 Në menynë që hapet, takoni aplikacionin që dëshironi të përdorni për të ndarë videon e përzgjedhur, pastaj ndiqni hapat përkatës për t'a dërguar atë.
- ! Ju mund të mos jeni në gjendje t'i kopjoni, dërgoni ose transferoni objektet e mbrojtura me të drejtat e autorit. Gjithashtu disa objekte mund të mos dërgohen nëse madhësia e skedarit është shumë e madhe.


### Për të fshirë një video

- 1 Në album, gjeni videon që dëshironi të fshini.
- 2 Prekni dhe mbani videon për të aktivizuar modalitetin e përzgjedhjes. Kuadri i miniaturës së videos shndërrohet në blu kur përzgjidhet.
- 3 Takoni , pastaj takoni **Fshi**.

### Shikimi i fotove tuaja në një hartë

Nëse aktivizoni zbulimin e vendndodhjes kur nxirni foto, mund t'a përdorni informacionin e mbledhur në një fazë të mëvonshme. Për shembull, mund të shihni fotot tuaja në një hartë dhe t'u tregoni miqve dhe familjes se ku ishit kur bëtë foton. Shtimit të informacionit të vendndodhjes i referohet gjithashtu si gjeotiketim. Kur aktivizoni zbulimin e vendndodhjes, mund të përzgjidhni të përdorni ose satelitët GPS ose rrjetet me valë ose të dyja për të gjetur pozicionin tuaj.

### Pamja e përgjithshme e pllakëzës Hartat







- 1 Kërkoni një vendndodhje në hartë.
- 2 Shihni opsionet e menysë.
- 3 Një grup fotosh dhe/ose videosh të gjeotiketuara me të njëjtën vendndodhje.
- 4 Trokitni lehtë dy herë për të zmadhuar. Afroni gishtat për të zvogëluar. Zvarrisni për të parë pjesë të ndryshme të hartës.
- 5 Miniaturat e grupit të përzgjedhur të fotove dhe/ose videoeve. Trokitni lehtë mbi një objekt për ta parë në ekranin e plotë.





### Për të bërë të mundur zbulimin e vendndodhjes

- 1 Nga Ekranin fillestar, trokitni lehtë mbi .
- 2 Gjeni dhe takoni **Cilësimet > Shërbimet e vendndodhjes**.
- 3 Shënoni **Satelitët GPS** dhe/ose **Shërb. për vendndodh. i Google** kutitë e shënimit.


### Për të parë fotot e gjeotiketuara në një album

- 1 Nga Ekрани fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeni dhe takoni **Albumi > Albumet e mia > Hartat**.
  - 3 Takoni një foto për t'a parë atë në ekranin e plotë.
  - 4 Nëse disa foto u bënë në të njëjtën vendndodhje, vetë një prej tyre shfaqet në hartë. Numri gjithsej i fotove shfaqet në cepin e sipërm djathtas, për shembull . Për të parë këto fotografi, takoni fotografinë e kopertinës dhe pastaj takoni një nga miniaturat në pjesë e poshtme të ekranit.
-  Kur shihni një foto të gjeotiketuar në shikuesin e fotove, mund të prekni ekranin për të shfaqur shiritat, pastaj takoni  për të parë foton në hartë.


### Për të parë fotot e gjeotiketuara në një glob në Album

- 1 Nga Ekрани fillestar juaj, takoni .
  - 2 Gjeni dhe takoni **Albumi > Albumet e mia > Bota**.
  - 3 Takoni një foto për t'a parë atë në ekranin e plotë.
  - 4 Nëse disa foto u bënë në të njëjtën vendndodhje, vetë një prej tyre shfaqet në hartë. Numri gjithsej i fotove shfaqet në cepin e sipërm djathtas, për shembull . Për të parë këto fotografi, takoni fotografinë e kopertinës dhe pastaj takoni një nga miniaturat në pjesë e poshtme të ekranit.
-  Kur shihni një foto të gjeotiketuar nga aplikacioni i kameras, mund të prekni ekranin për të shfaqur shiritat, pastaj takoni  për të parë foton në hartë.


### Për të shtuar një gjeotiketë kur shihni hartën në album

- 1 Kur shihni hartën në album, takoni , pastaj takoni **Shto gjeotiketën**.
- 2 Gjeni dhe takoni foton të cilës dëshironi t'i shtoni gjeotiketimin.
- 3 Takoni vendndodhjen e dëshiruar në hartë për të vendosur gjeotiketimin, pastaj takoni **OK**.

### Për të ndryshuar gjeotiketimin e një foto në album

- 1 Kur shihni një foto në hartën në album, prekni dhe mbani foton derisa korniza e saj të shndërrohet në blu.
  - 2 Tërhiqni foton në vendndodhjen e re.
-  Gjithashtu mund të takoni vendndodhjen e dëshiruar në hartë në vend që të tërhiqni.

### Për të ndryshuar shikimin e hartës në album

- Kur shihni hartë në album, takoni , pastaj përzgjidhni **Pamja klasike** ose **Pamja satelitore**.

## Shikimi i albumeve në Internet

Te albumi mund të shihni gjithashtu fotot dhe videot që ju dhe miqtë tuaj keni ngarkuar në shërbimet në Internet, si Picasa™ dhe Facebook™. Mund të shihni komentet nga miqtë tuaj dhe shtoni komentet tuaja gjithashtu.

## Pamja e përgjithshme e shërbimeve në Internet



1 Shërbimi aktiv në internet.


2 Emri i albumit në Internet.

3 Numri i objekteve në albumin në Internet.


4 Rifreskoni.

5 Shihni opsionet e menysë.


### Për të parë fotot nga shërbimet në linjë tek Albumi

- 1 Nga Ekranin fillestar, trokitni lehtë mbi .
- 2 Gjeni dhe trokitni lehtë mbi **Albumi > Albumet e mia**.
- 3 Trokitni lehtë mbi shërbimin e dëshiruar në linjë.
- 4 Trokitni lehtë mbi **Lidhu**. Shfaqen të gjitha albumet e disponueshme në linjë që keni ngarkuar në shërbim.
- 5 Trokitni lehtë mbi cilindo album për të parë përmbajtjen e tij, pastaj trokitni lehtë mbi një foto në album.
- 6 Goditni lehtë majtas për të parë foton ose videon pasardhëse. Goditni lehtë djathtas, për të parë foton ose videon e mëparshme.

### Për të parë dhe shtuar komente në përmbajtjen e albumit në internet

- 1 Kur shihni një foto nga një album në internet, takoni ekranin për të shfaqur shiritat, pastaj takoni  për të parë komentet.
- 2 Për të parë më shumë komente, lëvizni poshtë në ekran.
- 3 Për të shtuar komentet tuaja, futni komentet tuaja në pjesën e poshtme të ekranit, pastaj takoni **Postoni**.

### Për të rekomanduar një foto ose video në Facebook™

- Ndërsa shihni një foto ose video nga një prej albumeve tuaja të Facebook™, takoni ekranin për të shfaqur shiritin e veglave, pastaj takoni  për të trguar se e "Pëlqeni" objektin në **Facebook™**.

# Filmat

## Rreth aplikacionit Filmat

Përdorni aplikacionin Filmat për të riprodhuar filmat dhe përmbajtjet e tjera të videove që keni ruajtur në pajisjen tuaj. Aplikacioni Filmat gjithashtu ju ndihmon të merrni ilustrimin grafik, përmbledhjen e subjektit, informacionin e zhanrit dhe hollësitë e regjisorit për çdo film. Gjithashtu mund të riprodhoni filmat tuaj në pajisje të tjera që janë të lidhura në të njëjtin rrjet.

- ! Videot e bëra me kamerën e pajisjes tuaj shfaqen në aplikacionin Albumi, jo në aplikacionin Filmat.

## Pamja e përgjithshme e Filmave



- 1 Shihni opsionet e menysë
- 2 Shfletoni të gjitha videot tuaja të shkarkuara
- 3 Shfletoni të gjitha objektet e shkurtoreve tuaja
- 4 Shfletoni përmbajtjen në pajisjet e tjera të lidhura DLNA Certified™.
- 5 Skedari i videos – takojeni për t'a riprodhuar

- ! Video Unlimited mund të mos jetë e disponueshëm në të gjitha shtetet ose rajonet.




## Transferimi i përmbajtjes së videos në pajisjen tuaj

Para se të nisni përdorimin e aplikacionit Filmat, është më mirë të transferoni filmat, programet televizive dhe përmbajtje të tjera videoje në pajisjen tuaj nga pajisje të tjera, si p.sh. një kompjuter. Ka disa mënyra për të transferuar përmbajtjen tuaj:



- Vetëm për Windows®: Lidhni pajisjen me një kompjuter nëpërmjet një kabllaje USB dhe zvarrisni e lëshoni drejtpërdrejt skedarët e videove duke përdorur aplikacionin e menaxherit të skedarëve në kompjuter.
- Nëse keni një kompjuter PC ose Apple® Mac®, përdorni softuerin Xperia™ Companion për të organizuar përmbajtjet dhe për të transferuar skedarët e videove në pajisjen tuaj.

## Përdorimi i aplikacionit Filmat


### Për të riprodhuar një video te Filmat

- 1 Nga Ekranin fillestar, trokitni lehtë mbi , pastaj gjeni dhe trokitni lehtë mbi **Filmat**.
- 2 Gjeni dhe trokitni lehtë videon që dëshironi të riprodhoni. Nëse videoja nuk shfaqet në ekran, trokitni lehtë mbi **Të gjithë** në skedën **Koleksioni im** dhe më pas gjeni dhe trokitni lehtë mbi videon që dëshironi të riprodhoni.
- 3 Për të shfaqur ose fshehur kontrollet, trokitni lehtë mbi ekran.
- 4 Për të ndërprerë riprodhimin, trokitni lehtë mbi . Për të vazhduar riprodhimin, trokitni lehtë mbi .
- 5 Për t'u kthyer pas, tërhiqni shënuesin e shiritit të përparimit majtas. Për të kaluar përpara, tërhiqni shënuesin e shiritit të përparimit djathtas.


### Për të riprodhuar një video në regjimin e ekranit të plotë

- 1 Kur një video është duke u riprodhuar, trokitni lehtë ekranin për të shfaqur kontrollet.
  - 2 Trokitni lehtë mbi .
- ! Mund të kaloni në regjimin e ekranit të plotë vetëm nëse videoja nuk është duke u riprodhuar tashmë në regjimin e ekranit të plotë. Për të riprodhuar videon në madhësinë origjinale të saj, trokitni lehtë .

### Për të ndarë një video

- 1 Kur një video është duke u riprodhuar, takoni , pastaj takoni **Bashkëndaj**.
- 2 Në menynë që hapet, takoni aplikacionin që dëshironi të përdorni për të ndarë videon e përzgjedhur, pastaj ndiqni hapat përkatës për t'a dërguar atë.


### Për të marë informacionin e filmit me dorë

- 1 Sigurohuni që pajisja juaj ka një lidhje aktive të të dhënave.
  - 2 Nga Ekranin fillestar, trokitni lehtë mbi , pastaj gjeni dhe trokitni lehtë mbi **Filmat**.
  - 3 Trokitni lehtë mbi **Të gjithë** në skedën **Koleksioni im** për të shfletuar për te miniatura e një skedari, për të cilin dëshironi të merrni informacion.
  - 4 Prekni dhe mbani miniaturën e videos, pastaj trokitni lehtë **Kërkoni informacion**.
  - 5 Nëse kërkohet, lejojeni pajisjen tuaj të shkarkojë hollësitë e videos duke përdorur lidhjen e të dhënave celulare.
  - 6 Në fushën e kërkimit, futni fjalët kyçe për videon, pastaj trokitni lehtë mbi tastin e konfirmimit në tastierë. Të gjitha përkimet shfaqen në një listë.
  - 7 Përzgjidhni një rezultat kërkimi, pastaj trokitni lehtë mbi **U krye**. Shkarkimi i informacionit fillon.
- ! Mund të merrni automatikisht informacione për videot më të reja të shtuara çdo herë që hapet aplikacioni Filmat nëse shenjoni rutinë e zgjedhjes **Merr detajet video** nën Cilësimet. Mund të zbatohen tarifa për transmetimin e të dhënave.
- 💡 Nëse informacioni i shkarkuar nuk është i saktë, kërkoni përsëri duke përdorur fjalë kyçe të ndryshme.


### Për të pastruar informacionin për një video

- 1 Nga Ekranin fillestar, trokitni lehtë mbi , pastaj gjeni dhe trokitni lehtë mbi **Filmat**.
- 2 Trokitni lehtë mbi **Të gjithë** në skedën **Koleksioni im** për të shfletuar videon që dëshironi të modifikoni.
- 3 Prekni dhe mbani miniaturën e videos, pastaj trokitni lehtë mbi **Zbraz informacionin**.


### Për të riprodhuar një video në një pajisje të jashtme

- 1 Kur një video është duke u riprodhuar, trokitni lehtë mbi ekranin për të shfaqur kontrollet.
- 2 Trokitni lehtë mbi  > **Throw**.
- 3 Përzgjidhni një pajisje të jashtme në të cilën do të riprodhoni videon. Nëse nuk ka pajisje të jashtme të disponueshme, ndiqni udhëzimet në ekran për të shtuar një të tillë.

#### Për të ndryshuar cilësimet e tingullit ndërsa riprodhohet një video

- 1 Ndërsa riprodhohet një video, takoni ekranin për të afishuar kontrollet.
- 2 Takoni , pastaj takoni **Cilësimet e tingullit**.
- 3 Shënmoni kutitë e shënimit për cilësimet e tingullit që dëshironi të aktivizoni.
- 4 Kur të mbaroni, takoni **OK**.

#### Për të fshirë një video

- 1 Nga ekрани juaj fillestar, takoni , pastaj gjeni dhe takoni **Filmat**.
- 2 Përzgjidhni një kategori të videove dhe shfletoni tek video që dëshironi të fshini.
- 3 Prekni dhe mbani miniaturën e videos, pastaj takoni **Fshij** nga lista që shfaqet.
- 4 Takoni **Fshij** përsëri për të konfirmuar.

# Video pa kufi

## Rreth Video pa kufi

